



URDHËR

Nr. 108, datë 12 / 07 /2019

**PËR KOORDINIMIN E VEPRIMTARISË POLITIKE DHE KALENDARIN E PUNËS
PËR PERIUDHËN 15 KORRIK – 31 GUSHT 2019 NË TË GJITHA DEGËT E
PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 41 dhe 51 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, me qëllim garantimin e zbatimit të vendimeve të Kryesisë së Partisë dhe marrjes së masave të nevojshme organizative në nivel lokal, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm,

URDHËROJ:

1. Brenda datës 28 Korrik 2019 Degët e Partisë Demokratike të kenë përmbushur të gjitha detyrimet sipas vendimeve, udhëzimeve dhe urdhrave të strukturave qendrore të Partisë, si më poshtë vijon:

1.1. Vendimit nr. 1, datë 22.01.2019 të Kryesisë së PDSH “Për evidentimin e funksionarëve politik të Partisë Demokratike ndër vite dhe drejtuesve ndër vite të PDSH dhe të degëve të saj, si dhe nxitjen e nivelit të angazhimit të tyre aktual në mbështetje të PDSH-së” (Aneksi 2);

1.2. Vendimit nr. 2, datë 22.01.2019 të Kryesisë së PDSH “Për përdorimin e rrjeteve sociale si mjet për përhapjen e mesazhit politik të strukturave drejtuese të Partisë” (Aneksi 3);

1.3. Vendimit nr. 3, datë 22.01.2019 të Kryesisë së PDSH “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Këshilltarëve pranë Degëve të Partisë Demokratike të Shqipërisë” (Aneksi 4);

1.4. Vendimit nr. 4, datë 25.01.2019 të Kryesisë së PDSH “Për emërimin e sekretarëve funksional të Degëve të Partisë Demokratike të Shqipërisë” (Aneksi 5);

1.5. Vendimit nr. 6, datë 22.02.2019 “Për ngritjen e Shtabeve Politike, në nivel qendror dhe lokal” (Aneksi 6);

1.6. Udhëzimit nr. 40, datë 23.03.2019 të Kryetarit “Për evidentimin e personave me influencë në Degë, mekanizmi për të testuar dhe marrë mbështetjen e tyre ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe regjistrimi i tyre si simpatizantë të PDSH-së” (Aneksi 7).

1.7. Vendimit të Këshillit Kombëtar për krijimin e Aleancës Qytetare për Mbrojtjen e Demokracisë (Aneksi 8).

2. Brenda datës 28 Korrik 2019 Degët e Partisë të plotësojnë të gjithë strukturën statutore të Partisë, duke filluar më pozicionet e Nënkryetarëve, Sekretarëve FunkSIONAL, anëtarëve të Bordit të Këshilltarëve, Kryetarin e Bordit Financiar, sekretarët e Grupseksioneve, etj.

2.1. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Degët e Partisë duhet të mbajnë në konsideratë nevojën për përfshirjen në Kryesi të personaliteteve me eksperiencë politike dhe profesionale në Degë, si dhe kombinimin e tyre me nevojën për promovimin e të rinjve dhe grave në funksione drejtuese në Parti.

2.2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm me ndjekjen e përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.1 nga Degët e Partisë dhe me urdhër të Kryetarit të Partisë, pas autorizimit nga Kryesia e PDSH-së, zbaton të drejtën e ndërhyrjes, sipas nenit 45 të Statutit të Partisë, sa herë vlerësohet e nevojshme, me qëllim ruajtjen e ekulibrave të brendshëm në Degë.

2.3. Degët e Partisë dorëzojnë një kopje të akteve të zgjedhjeve brenda Partisë, në cdo funksion, tek Sekretariatit Organizativ i Partisë.

2.4. Organizatat partnere bëjnë plotësimin e strukturës së tyre, në cdo rast ku ka vakanca.

3. Brenda datës 15 Gusht 2019 Degët e Partisë të plotësojnë kontaktet (adresën dhe numrin e telefonit) e listës së antarësisë së PDSH duke marrë kontakt në nivel seksioni me çdo anëtar partie.

3.1. Gjatë realizimit të këtij procesi verifikohet edhe performanca e çdo seksioni dhe drejtuesve të tij.

3.2. Ky proces realizohet nga Kryetari i Grupseksionit, nën monitorimin e drejtëpërdrejtë të Kryetarit të Degës.

4. Brenda datës 20 Korrik 2019 Degët e Partisë të hartojnë një kalendar aktiviteteve politike, për periudhën 22 Korrik – 31 Gusht, duke përfshirë takime me anëtarët e partisë, grupet e interesit në zonë, individë me influencë në zonë, ish-drejtues të strukturave të partisë apo pushtetit lokal

në zonë, verifikim të listave të votuesve për çdo QV dhe analizën mbi performancën e të gjitha strukturave në nivel seksioni dhe grupseksioni.

4.1. Organizatat partnere në nivel Dege bëjnë gjithashtu një kalendar aktiviteteve në koordinim me strukturat drejtuese të Degës.

4.2. Kalendar i aktiviteteve politike i njoftohet menjëherë anëtarëve të Kryesisë dhe deputetëve që mbulojnë zonat përkatëse, si dhe anëtarëve të Këshillit Kombëtar të caktuar në Degë, të cilët angazhohen në realizimin e Kalendarit të aktiviteteve, me përjashtim të rasteve kur ato janë të angazhuar me detyra sipas këtij urdhri.

5. Për koordinimin e veprimtarisë organizative dhe ndjekjen e zbatimit të Kalendarit të punës sipas këtij urdhri, ngrihet Grupi i Punës, me përbërje dhe i ndarë sipas zonave, të përcaktuara në Ankesin 1 bashkëlidhur këtij urdhri.


5.1. Koordinator i ndjek të gjithë procesin e përmbushjes së detyrave sipas këtij urdhri dhe përgjigjet për veprimtarinë e tij përpara Kryetarit të Partisë.

5.2. Koordinator informon Kryetarin e Partisë, të paktën një herë në javë dhe në çdo rast sa herë i kërkohet, mbi ecurinë e përmbushjes nga Degët të përgjegjësive sipas këtij urdhri. Ai siguron prezencën e tij të pandërprerë në zonë, gjatë gjithë periudhës 15 Korrik – 31 Gusht 2019.

6. Ngarkohet Sekretari Funksional përgjegjës për organizimin për njoftimin e këtij urdhri të gjitha strukturave dhe Degëve të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Lulzim Basha
LULZIM BASHA

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
GAZMENT BARDHI

Gazment Bardhi

A N E K S I 1:
GRUPI I PUNËS PËR KOORDINIMIN E VEPRIMTARISË ORGANIZATIVE NË
NIVEL QARKU

Nr.	QARKU	KOORDINATOR
1.	RAJONI TIRANA 1 (Degët 1, 2, 3)	HEKURAN HOXHALLI
2.	RAJONI TIRANA 2 (Degët 4, 5, 12)	ALBANA VOKSHI
3.	RAJONI TIRANA 3 (Degët 6, 7, 8)	ALDO BUMÇI
4.	RAJONI TIRANA 4 (Degët 9, 10, 11)	ORJOLA PAMPURI
5.	RAJONI TIRANA 5 (Degët 14, 15, 16)	EDMOND SPAHO
6.	RAJONI TIRANA 6 (Degët 13, Vorë, Rrogozhinë)	OERD BYLYKBASHI
7.	RAJONI TIRANA 7 (Degët Kavajë, Kamëz, Paskuqan)	EDI PALOKA
8.	RAJONI DURRËS 1 (Dega Durrës)	GENT STAZIMIRI
9.	RAJONI DURRËS 2 (Dega Shijak, Krujë, Fushë-Krujë)	BUJAR VUKAJ
10.	RAJONI ELBASAN 1 (Degët Elbasan, Librazhd, Prrenjas)	FLAMUR NOKA
11.	RAJONI ELBASAN 2 (Degët Belsh, Cërrik, Gramsh, Peqin)	ALBERT AVDYLI
12.	RAJONI FIER 1 (Degët Fier, Patos dhe Mallakastër)	ARBEN IBRO
13.	RAJONI FIER 2 (Lushnje, Divjakë dhe Roskovec)	BERNARD BANUSHI
14.	RAJONI VLORE 1 (Degët Vlorë dhe Selenicë)	ERVIN MINAROLLI
15.	RAJONI VLORE 2 (Degët Himarë, Delvinë, Sarandë)	ILIR DERVISHI
16.	RAJONI SHKODËR 1 (Degët Shkodër dhe Malësi e Madhe)	GAZMENT BARDHI
17.	RAJONI SHKODËR 2 (Degët Vau i Dejës dhe Pukë)	AHMET PREMÇI

18.	RAJONI KORÇË 1 (Degët Korçë, Maliq, Kolonjë)	SAHIT DOLLAPI
19.	RAJONI KORÇË 2 (Degët Pogradec, Devoll)	ENDRI HASA
20.	LEZHË	FLAMUR HOXHA
21.	BERAT	TAULANT ZENELI
22.	DIBËR	ENKELEJD ALIBEAJ
23.	GJIROKASTËR	ERVIN SALIANJI
24.	KUKËS	KRESHNIK ÇOLLAKU